

# Pika më e rëndësishme për laktacion

*Përktheu dhe përpunoi Olger Nanagjoka*



*Pika më e rëndësishme për laktacion. Kalimi (tranzicioni) nga lopët barsë pa qumësht në lopët jo-barsë me qumësht është një fazë shumë e rëndësishme për çdo lopë. Koha e lindjes e çon ekuilibrin hormonal të kafshëve në trazira. Nga kjo kuptohet sa e rëndësishme është të siguroshnjë kalim të qetë për lopët për këtë periudhë rreth 3 javë në 4 javë pas lindjes.*

Sëmundjet metabolike të lopës së qumështit kryesisht të lidhura me ushqyerjen – ethet e qumështit, ketoza, placenta e mbetur dhe ndryshimi i abomasës – shfaqen brenda javëve të para të laktacionit. Të tjera, të tilla si sëmundjet e thundrës, që nuk janë të dukshme në javët e para të laktacionit, e kanë origjinën e tyre në këtë periudhë.

Këto sëmundje të lidhura me ushqyerjen të shkaktuara nga rënia e prodhimit të qumështit kërkojnë trajtim veterinar si dhe mund të çojë në largimin e mundshëm të kafshës; këto janë kosto të konsiderueshme për fermën. Nëse paraqesim analizat e gjakut për kontrollin e normave metabolike të lopëve, vlerat e enzimave dhe substrakteve tregojnë shpesh ngarkesa ekstreme metabolike të lopëve në periudhën e pas-lindjes.

Tre aspekte janë të një rëndësie të veçantë për një tranzicion të qetë nga periudha e tharjes në laktacion:

1. Adaptimi i Rumenit me një dendësi të lartë të energjisë së ushqimit në laktacion, për një bilanc pozitiv të energjisë.
2. Ruajtja e një përqindje të lartë Ca në gjak gjatë pjelljes.
3. Ruajtja e një sistemi të mirë imunitar.

## **Faza e ushqyerjes**

Këto kërkesa mund të plotësohen më së miri, nëse të ushqyerit tranzit është e ndarë në një fazë ushqyerje para pjelljes dhe në një fazë fillestare pas pjelljes.

Objektivat në fazën e ushqyerjes janë:

- Energji e mjaftueshme për rritjen e embrionit dhe zmadhimin e gjinjve
- Parandalimi i rënies në peshë
- Përgatitja e rumenit, në mënyrë që të mund të administrohet ushqimi me sasi energjie në fillim të laktacionit
- Nxitja e rritjes së rumeinit
- Përshtatja e racionit pas pjelljes
- Sigurimi i një racioni të mire ripërthypës.

Sasia e ushqyerjes së kafshës deri në kohën e lindjes është në rënie, por njëkohësisht rritetet nevoja për lëndë ushqyese.

Prandaj është e rëndësishme që sasia e ushqyerjes të mbahet sa më e lartë të jetë e mundur. Lopët që hanë shumë para pjelljes, bëjnë të njëjtën gjë dhe pas.

Sasia e ushqyerjes nxitet përmes përdorimit të ushqimeve me cilësi të lartë, ndryshimit të butë të racionit, parandalimit të lopëve mbi peshë dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme kushtet e mira të mbajtjes. Racioni tranzit 2-3 javë para pjelljes duhet të jetë një ushqim i mirëstrukturuar me

cilësi të lartë për një furnizim me lëndë të thatë prej rreth 10-12 kg në ditë me 6,4-6,6 MJ NEL për kg TM, 15% proteina të papërpunuara, mundësisht 18% celulozë ose 300 g celulozë për 100 g peshë trupore, një vlerë e ulët DCAB dhe vitamina me cilësi të lartë si dhe elemente të tjera (Vitamina A, D3, E, B, Beta-Karroteni, Selenium, Zink).

Në fazën e ushqyerjes në racion shtohen sasi acidi - MF Rindavit (300 g për ditë dhe kafshë) dhe kripërat e acidit në mënyrë që të ulët ekuilibri i anione-katione. Kjo strategji është e rekomanduar për një kontroll të mirë të racionit dhe bilancimin e të gjitha ushqimeve. Në këtë rast, kationet e synuara shpohen dhe duhet patur kujdes që racioni i përgjithshëm të vazhdojë të përmbajë deri në 120 g Kalcium, si dhe rreth 50g Fosfor.

Nëse nuk aplikohet MF Rindavit, faza e ushqyerjes me Rindavit VK mund të ketë më shumë efekt. Ndryshe nga acidi Rindavit MF furnizimin me Canë javët e fundit para pjelljes duhet të jetë sa më i ulët të jetë e mundur.

Shtesat me vitamina dhe substanca me përmbajtje glukoze realizohet nëpërmjet produkteve Schaumann-Energizer, Schaumasil TMR ose RindavitExtra.

## **Pjellja**

Pjellja duhet të bëhet në një ambient të veçantë pa stres. Direkt pas pjelljes pija energjike Rindavit përzihet me rreth 15 - 20 litra ujë të vakët në një kovë dhe jepet mundësisht që në orët e para. Lopët e pranojnë pa problem pijen energjike Rindavit. Ajo e furnizon lopën me sasi të larta energjie, nxit florën në Rumein dhe ndihmon në një konsum të lartë fluidesh menjëherë pas pjelljes. Rindavit - pija energjike i jep mundësinë lopës për një rifillim të mirë.

## **Faza e fillimit**

Për shkak se furnizimi me ushqim është gradualisht në rritje pas pjelljes ka një deficit në ekuilibrin e furnizimit me ushqim të kafshëve. Pasojë e këtyre çekuilibrave është mobilizimi i yndyrës së trupit. Këtu shfaqen sasi të larta të acideve yndyrore në gjak, të cilat nuk janë përfshirë në ciklin e acidit citric.

*Të ushqyerit optimalë gjatë periudhës së tranzitit është ndër kushtet më të rëndësishme për lopë të shëndetshme dhe me rendiment të lartë.*

Të gjitha hapsirat janë tashmë të zëna për formimin e glukozës. Glukoza – burimi kryesor i energjisë për lopën - është jashtëzakonisht e nevojshme në kohën e pjelljes. Acidet e lira yndyrore shndërrohen në ketone dhe depozitohen në mëlçi, e cila shkakton probleme metabolike dhe çon në zmadhimin dhe sëmundjen e mëlçisë.



**Diagrama 1: Ndikimi i mëlçisë me përmbajtje të lartë yndyrore në ndryshimin e vlerave të gjakut**

	Sasia yndyrore në mëlçi		
	e ulët ( <20%)		e lartë (20 – 40%)
Acide të lira yndyrore (mmol/l)	0,58	0,70	0,99
Ketone(mmol/l)	3,17	15,60	0,95
Glukoze (mmol/l)	1,59	1,87	2,94
Insuline (mU/l)	1,85		11,40
Hormone luteinike			
2 Javë p.p. (µg/l)			1,49
3 Javë p.p. (µg/l)			1,52
4 Javë p.p. (µg/l)			1,59

Burimi : Stangassinger, 1990

Lidhja direkte ndërmjet humbjes së yndyrës së trupit në periudhën e bilancit të energjisë dhe problemeve në aspektin e pjellorisë mund të shihet në diagramin 1 dhe 2. Kafshët me përmbajtje të lartë yndyrë në mëlçi kanë nivele më të larta të acideve të lira yndyrore dhe ketoneve, prodhojnë më pak insulinë dhe si pasojë më pak glukozë. Këto kafshë shfaqin simptomat e diabetit.

Në mënyrë të ngjashme, vlerat e hormonit luteinik në këtë grup për javë pas pjelljes janë dukshëm më të ulta se sa tek kafshët me përmbajtje të ulët yndyre në mëlçi (shih diagramën 1). Forma e dobët e hormoneve luteinike është si pasojë, përgjegjëse për veprimtarinë dhe cilësinë e dobët

ovariane. Afshi i parë pas lindjes është shpesh ende qartësisht i dukshëm. Krijimi i folikulave ka ndodhur gjatë periudhës së tharjes, në një kohë në të cilën kafsha ka pasur një kujdes të mirë. Afshet e mëvonshme janë shpesh të dobëta. Këtu folikulat hasen me procesin e bilancit të energjisë dhe clirimin e yndyrave.

Diagrami 2 tregon qartë se kafshët me një ndryshim të fortë në gjendje të trupit pas lindjes shfaqin qartë tipare më të varfra fertiliteti, si p.sh. një normë konceptimi në barsjen e parë prej vetëm 17% krahasuar me 65% te kafshët me mobilizim të ulët të yndyrës. Kështu mund të thuhet se: *"sa më pak yndyrë të mobilizohet para dhe pas pjelljes, aq më pak probleme ka në periudhën në vazhdim."*

<b>Diagrama. 2: Raporti midis humbjes së peshës së trupit në 5 javët e para pas pjelljes dhe pjellshmërisë</b>			
	Gjendja		
	> 1,0 Pkt	<0,5 Pkt	0,5 – 1,0 Pkt
Numri i kafshëve	17	64	12
Ditët deri në ovulacionin e parë	27	31	42
Ditët deri në afshin e parë të zbuluar	48	41	62
Ditët deri nëbarsjen e parë	68	67	79
Shkalla e konceptimit tëbarsjes së parë (%)	65	53	17
Barsje për konceptim	1,8	2,3	2,3
Infeksioni i mitrës (%)	6	22	47

Burimi: Butler & Smith, 1989

Duke qënë se furnizimi me glukozë ka një rëndësi të madhe për rendimentin, shëndetin dhe fertilitetin e kafshës, nga ana tjetër në këtë fazë konsumi i energjisë nuk është ende optimal, kontrolli metabolik mund të përmirësohet dukshëm nëpërmjet produkteve të tilla si SCHAUMANN Energizer, Schaumasil TMR ose Tirsana.

Për të siguruar edhe pas pjelljes një racion të përshtatshëm ripërtypës, kur furnizimi me ushqim rritet gradualisht, duhet patur kujdes që ndërprerja e ushqimit dhe rritja e të ushqyerit me koncentrate të mos çojë në rënien e konsumit të foragjereve. TMR nuk duhet të jepet me densitet

të lartë energjie menjëherë pas pjelljes, përveç nëse lopët kanë nevojë të marrin një furnizim shtesë me ushqim të fortë.

Duke qenë se përbërësit e ushqimit, racionet dhe kushtet strukturore në ferma janë shumë të ndryshme, është e rekomandueshme që rruga tranzit të mbulohet së bashku me keshilluesin e Austria Prämix SCHAUMANN. Ai përcakton me ju përdorimin e produkteve përkatëse të SCHAUMANN në mënyrë që lopët në çdo laktacion të kenë rendiment dhe pjellshmëri të lartë.